

V E N D I M
Nr.9, datë 17.1.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NR.504, DATË 18.10.1993 “PËR EMETIMIN E OBLIKACIONEVE SHTERËRORE PËR KOMPESIMIN E ISH-PRONARËVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”

Me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.504, datë 18.10.1993, pika 1 ndryshohet si vijon:”Titujt që do të shërbejnë për kompesimin e ish-pronarëve dhe ish-të përndjekurve politikë, do të quhen obligacione shtetërore. Në to do të pasqyrohen shkaku i emëtimit, vlera nominale, e drejta e poseduesit për t’i shkëmbyer (ose shitur) lirisht, si dhe detyrimi i shtetit për t’i njohur si mjet pagese për blerjen e pasurisë shtetërore”.

2. Pika 3 ndryshohet si vijon :”Forma e obligacionit të jetë sipas standardit të ri që i bashkëlidhet këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TE MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

**OBLOGACION SHTETËROR PËR KOMPESIMIN E ISH-PRONARËVE
DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË**

N:SERIE

Vlefë nominale e këtij obligacioni është:

Lekë

Ky obligacion shtetëror emetohet nga Ministria e Financave në zbatim të ligjeve nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave të ish-pronarëve”, nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompesimin në vlerë të ish- pronarëve të tokës bujqësore”, dhe nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”.

Shteti e njeh këtë obligacion vetëm në procesin e privatizimit të pasurisë shtetërore, në bazë të vlerës së tij minimale deri në 31.12.2000.

Zotëruesi i këtij obligacioni është i lirë ta shesë me çmimin që dëshiron, dhe ta transferojë në çdo formë tjetër jo të kundërligjshme.

Datë _____

(firma)
Ministri i Financave